



QENDRA E APLIKIMIT PËR VISA TLSCONTACT - KOSOVË

LISTA E DOKUMENTEVE

VIZA TURISTIKE

Dëshironi të shkoni në Zvicër, Austri, Belgjikë, Francë, Luksemburg ose Holandë për një vizitë turistike dhe do të qëndroni jo më gjatë se 90 ditë.

Keni parasysh që Konsullata mund t'ju kërkojë që të dorëzoni dokumente ose informacione shtesë, sipas situatës suaj personale, madje edhe pas dorëzimit të aplikacionit tuaj në TLScontact. Ju lutemi që ta keni parasysh që dorëzimi i aplikacionit të plotë nuk garanton dhënien e vizës.

Forma e aplikacionit për vizën Schengen (Origjinal)

*Duhet të plotësohet si duhet, t'i vendoset data dhe të nënshkruhet nga aplikuesi. Duhet të plotësohet online dhe të printohet në formatin pdf. **Në rastin e të miturve (nën moshën 18 vjeçare):** Nëse udhëtoni të pa shoqëruar ose vetëm me njërin prind, një letër pëlqimi nga prindi/ërit duhet të dorëzohet. Për më tepër, të dy prindërit duhet ta nënshkruajnë formën. Përjashtimet do të bëhen nëse prindi i vetëm me të cilin i mituri do të udhëtojë ka autoritetin e vetëm prindëror. Prindi i vetëm duhet ta dorëzojë një dokument zyrtar që dëshmon që ai/ajo është autoriteti i vetëm prindërori, p.sh. certifikatën e vdekjes, marrëveshjen e shkurorëzimit ose marrëveshjen e kujdestarisë.*

Një fotografi me ngjyrë me madhësi të pasaportës (Origjinal)

Jo më të vjetra se 6 muaj, të padëmtuara, sfondi duhet të jetë i ndriçueshëm dhe i dukshëm, sipas specifikimeve të ICAO.

Pasaporta (Origjinal)

Pasaporta nacionale e vlefshme për më tepër se 3 muaj përtej vlefshmërisë së vizës së kërkuar, me së paku dy faqe të zbrazëta për vizë (nuk është e nevojshme që faqen të jenë njëra pas tjetrës).

Pasaporta (Kopje)

Kopja e pasaportës përfshirë faqet me foto, të dhënat personale, dhe faqet e vizës Schengen, nëse është e zbatueshme.

Certifikata e Gjendjes Civile (Origjinali)

Certifikata e lindjes, certifikata e bashkësisë familjare, certifikata e martesës, Çertifikata e vdekjes (nëse i/e ve), jo më të vjetra se 6 muaj.

Dëshmi e mjeteve të mjaftueshme për jetesë (p.sh.)

Origjinali i pasqyrave të llogarive bankare që paraqesin transaksionet (qarkullimi i llogarive) për gjashtë muajt e fundit dhe saldën e llogarisë ose; Pasqyra e pagës ose dëshmia e të ardhurave të rregullta.



Për personat e punësuar:

Kontrata e punës (Kopje) dhe konfirmimi i pushimit nga punëdhënësi me përkthim në njërën nga gjuhët zyrtare në Zvicër (D, F, I) ose në gjuhën angleze; Dëshmia e pagimit të kontributeve në Trustin Pensional të Kosovës për 6 muajt; Pasqyra Bankare për 6 muajt e fundit.

Për pronarët e kompanisë:

Certifikata e regjistrimit të biznesit;
Certifikata tatimore e kompanisë së Kosovës nga autoriteti tatimor.

Për nxënësit / studentët:

Letër nga shkolla / universiteti;
Kartela studentore ose kopja e regjistrimit në universitet dhe indeksi i studentit i nënshkruar dhe vulosur nga universiteti dhe transkripti aktual i notave (i printuar nga sistemi elektronik i Universitetit);
Dëshmia e aftësisë pagueuse të prindërve (p.sh. kontrata e punës dhe pasqyra e llogarisë bankare), ose dëshmia e mjeteve të mjaftueshme për tërë qëndrimin, ose ofrimin e formës së garancisë.

Për bujqit: Dëshmia e pronësisë së pronës

Për personat e pensionuar: Pasqyrat e pensionit për 6 muajt e fundit

Dëshmia e akomodimit (Kopje)

p.sh. konfirmimi i rezervimit të hotelit

Itinerari i udhëtimit (Kopje)

Sigurimi shëndetësor i udhëtimit

Që mbulon tërë periudhën të qëndrimit të synuar. Sigurimi duhet të jetë në pajtim me kushtet e Schengen-it si në vijim:

- Zona e mbulimit duhet t'i përfshijë të gjitha shtetet anëtarë të Schengen;
- Shpenzimet mjekësore emergjente dhe kostot e riatdhetësimit duhet të kenë një mbulesë minimale prej 30,000 euro;
- Kushtet dhe kriteret e sigurimit duhet të bashkëngjiten.

Letra e autorizimit për aplikacionin e vizës /kthimin e pasaportës (Origjinal)

E obligueshme nëse vendosni ta dorëzoni aplikacionin tuaj përmes përfaqësuesit.

Dokumentet mund të paraqiten nga përfaqësuesit (nëse regjistrimi i të dhënave bio-metrike nuk kërkohet ose gjurmët e gishtave janë mbledhur brenda 59 muajve të fundit me qëllim të aplikimit për një Vizë Shengen).

Letërnjoftimi ose pasaporta e Përfaqësuesit (Origjinal + Kopje)

E obligueshme nëse vendosni ta dorëzoni aplikacionin tuaj përmes përfaqësuesit.